



Pranuar / Dorezuar Pimljenol/Prodato Received / Delivery	24. 11. 2022	2	viti god veqir
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBHCK	7389/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.727/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti kryetar, Malsore Gashi – Bajraktari, dhe Eshref Shabani si dhe Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses ,sipas Aktgjykimit A.nr.2255/21 të datës 24.10.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.727/2021 të datës 06.08.2021 të parashtruar nga ankuesi [redacted], me adresë banimi [redacted]

[redacted] kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “Ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 24.11.2022, mori këtë;

V E N D I M

I. Detyrohet Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës që të bëjë ri-shqyrtimin e vendimit me nr.4165 të datës 09.07.2021,duke ndërmarrë veprimet administrative brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës, që ti ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda afatit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.

III. Detyrohet Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të ndërmerr veprimet konformë përgjegjësiive ligjore sipas Pikës I të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



Arsyetim

Ankuesi [REDACTED] i punësuar në pozitën Zyrtar i lartë për çështje pronësore në Drejtorinë e Pronës në Komunën e Prishtinës sipas Akt emërimit të datës 01.02.2017 me Nr. 01.nr.112-486, me datë 09.07.2021 Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës i shqipton masën disiplinore "largim nga shërbimi civil".

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me nr.4165 të datës 09.07.2021 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës me datën 06.08.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave me datë 11.08.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Prishtinës. Komuna e Prishtinës me datë 24.08.2021 ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/11.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga data 30.06.2021 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 21.09.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi pasi ka pranuar Njoftimin e datës 21.09.2021 me numër protokolli 4720/2021, ka parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, duke iniciuar konflikt administrativ, e cila me datë 24.10.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.2255/2022 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e ankuesit, duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 21.09.2021 për ankesën me numër A.nr.727/2021, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 06.08.2021 me numër protokolli 4121/2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova : Ankesa e datës 06.08.2021 me nr. Prot: 4121/2021e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës me Nr. 4165 të datës 09.07.2021; Vërtetim noterial i kopjes nga origjinali me Nr.8444/2021 të datës 09.06.2021; Njoftimi i datës 09.06.2021 me Nr.Ref. 14-116/01-105334/21 i lëshuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Formular për raportimin e shkeljes disiplinore me nr.14-116/01-105334/2021 të datës 27.05.2021; Raport mjekësor i datës 21.01.2021 nga Olive- medical laboratory; Raport mjekësor i datës 14.06.2021 nga Olive- medical laboratory; Raport mjekësor i datës 27.05.2021 nga Olive- medical laboratory; Përgjigjeje në ankesë nga organi i punësimit të datës 24.08.2021 me Nr.Prot: 4315/2021 bashkë me shkresat e lëndës faqe.1/11; Akt emërimi i datës 01.02.2017 me Nr. 01.nr.112-486; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 27.01.2021; Aktgjykimi A.nr.2255/21 i datës 24.10.2022 të Gjykatës

Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimi i datës 21.09.2021 me numër protokoll 4720 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Provat e kërkuara përmes e-mailit nga Njësia e Personelit të cilat Këshilli i ka pranuar me datën 02.11.2022 me numër protokoll 6652/2022; Kërkesë 27.05.2021 e protokolluar me datën 08.06.2021 me numër protokoll 14-116/01-105334/21.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore që lënda të kthehet në **Rishqyrtim te organi i njejtë që ka nxjerrë vendimin e kontestuar.**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës ka nxjerr Vendimin me nr.4165 i datës 09/07/2021, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "largim nga Shërbimi Civil".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dosjen e lëndës, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor nuk ka arritur që të vërtetoj drejtë gjendjen faktike sepse nga provat e lëndës që posedon nga ankuesi dhe organi i punësimit nuk vërtetohet me prova konkrete se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore. Në arsyetimin e vendimit të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës thuhet se Udhëheqësi i Sektorit të Pronës në drejtorinë e Pronës në Komunën e Prishtinës, ka përpiluar një raport ku supozohet se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, por nuk elaborohet fare se ku janë bërë shkeljet përkatësisht duke konkretizuar çdo shkelje me fakte që argumentojnë vendimin. Poashtu ankuesi ngarkohet se ka munguar në punë një kohë të gjatë mirëpo nuk është vërtetuar me asnjë provë se kur ka munguar duke specifikuar datat dhe shkaqet e mungesës,poashtu thuhet se ankuesit i janë dhënë shumë vërejtje gojore,por se me asnjë provë nuk është argumentuar një faktë i tillë,poashtu Këshillit nuk i është ofruar procesverbali i Komisionit Disiplinor të seancës dëgjimore të zhvilluar me datë 18.06.2021 për të vërtetuar se çfar kanë deklaruar palët lidhur me shkeljen disiplinore. Në vendim përkundër që thuhet se ankuesi ka pasur shkelje në vazhdimësi të obligimeve që dalin nga mardhënia e punës por nga komisioni disiplinor dhe organi i punësimit nuk kemi asnjë dëshmi për ndonjë masë disiplinore që i është shqiptuar ankuesit më parë.Poashtu nëse shohim vendimin e komisionit disiplinor përkatësisht arsyetimin e tij konstatohet fakti se arsyetimi nuk përputhet me njoftimin nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës i cili përmes shkresës së datës 09/06/2021 drejtuar ankuesit, i cili deklaroi se inicimi i procedurës disiplinore është bërë me datë 08/06/2021 nga Drejtori i Drejtorisë së Pronës në Komunë të Prishtinës,përkatësishtë B.M,ndërsa në arsyetim të vendimit të kontestuar thuhet se Xh.Z, Udhëheqës i Sektorit të Pronës në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës,ka përpiluar raportin për një shkelje të rëndë të supozuar disiplinore,dhe mbi këtë rrethanë për kolegjin mbetet rrethanë e pasqaruar se nga cili zyrtarë është inicuar procedura disiplinore ndaj ankuesit.Sipas raportit të shkeljes disiplinore të datës 08/06/2021 mbi të cilin raportë ka vendosë komisioni disiplinor masën disiplinore ndaj ankuesit,konstatohet fakti se te nënshkrimi i inicimit të kësaj procedure,përkatësishtë në formularin e inicimit,faqja e dytë figuron data 27/05/2021 ndërsa vendimi i komisionit disiplinorë është i datës 08/07/2021,ndërsa kolegji me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese nuk ka hasë në ndonjë akt administrativë në lidhje me shtyrjen e vendimarrjes bazuar në dispozitat e LPPA-së,andaj edhe kjo rrethanë mbetet e pasqaruar nga komisioni disiplinor.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke marrë parasysh rrethanat si më lartë, konstaton se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me nr.4165 i datës 09/07/2021, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "largim nga Shërbimi Civil" nuk ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative në të cilat dispozita parashihet: "1.Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;1.2.shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;1.3.shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;1.4.bazën ligjore të vendimit dhe arsyeve pse është e zbatueshme në rastin konkret;1.5.shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;1.6.në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim;2.Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, obligon Komisionin Disiplinor në Komunën e Prishtinës , që me rastin e rishqyrtimit të lëndës së ankuesit Gani Islami, të veprojë në pajtim me të gjeturat e këtij vendimi, duke shqyrtuar në mënyrë meritore secilën shkelje të supozuar, si dhe mbi bazë të argumenteve të vendos meritorisht për masën disiplinore duke u bazuar në Legjislacionin e Shërbimit Civil.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda: A nr.727/2021, datë 24.11.2022

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunë të Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.